

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Karamuço zbardh historinë e fortë të Alket Rizait: E dinin në burg por e ndaluan në post-blok - Euronews s Albania                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://euronews.al/karamuco-zbardh-historine-e-for-te-alket-rizait-e-dinin-ne-burg-po-r-e-ndaluan-ne-post-blok/">https://euronews.al/karamuco-zbardh-historine-e-for-te-alket-rizait-e-dinin-ne-burg-po-r-e-ndaluan-ne-post-blok/</a> |
| BURIMI  | euronews.al                                                                                                                                                                                                                                     |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                          |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 14 shtator 2026, 20:33:09 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 20:26:36 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 04704f15a7922c0506e7c1299ec7df903c26408521869363ee937d7b2557fdce |
| TEKSTI     | ae37e804ed5440959a76b038b4ca0226689c6be5d3fe4a9c6010e18fd99be7a3 |
| PAMJA      | 021cedfc15581649d5586ae220fdc99786b4820b858c84c857484b60673600c7 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 79f0e6c3a3634d7700840c5faf9e3094c2b9b7907393826120e8f6ce410050c0                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79f0e6c3a3634d7700840c5faf9e3094c2b9b7907393826120e8f6ce410050c0>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




## TREND

Bekim Sejdiu Inteligjenca Artificiale Bashkimi Evropian Donald Trump Erion Veliaj

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

## Karamuço zbardh historinë e fortë të Alket Rizait: E dinin në burg por e ndaluan në post-blok



14 Shtator 2026 | 22:26

Eksperti Ervin Karamuço ka folur në "Now" për historitë e arratisjeve dhe profilin e Alket Rizait. Ai thekson se arratisjet spektakolare me helikopter kanë ndryshuar standardet e sigurisë në burgjet evropiane, duke sjellë vendosjen e rrjetave të sipërme në ambientet e ajrimit për të parandaluar ngjarje të ngjashme.

"Masat që u morën në rang evropian ishin vendosja e rrjetave të sipërme në ambientet e ajrimit. Ne nuk e kemi pasur këtë përpara. Ne tani e kemi vendosur më shumë për dronët, por helikopteri nuk është një gjë e pamundur edhe te 313 ose në burgje të tjera, sidomos në ato që kanë sheshe të hapura ku mundësia për të vajtur me një helikopter privat është e madhe. Standardet dhe rregullat e sigurisë mbi sigurinë kanë ndryshuar në nivel evropian".

Karamuço shpjegon burgun ku qëndronte Rizai, një ambient me kushte mjaft të rënda, por nga ana tjetër, me një hapësirë që bën të mundur lehtësisht hyrjen e një helikopteri për arratisje.

"Koridhalosi ishte burgu ku u arratis Alket Rizaj. Është burgu më famkeq ku shkelen çdo ditë të drejtat e njeriut. Ka një mbingarkesë të jashtëzakonshme.

Të gjithë këta komisionerë të të drejtave të njeriut, qoftë të OKB-së apo Këshillit të Evropës, kanë thënë që aty ka një torturë ç'njerëzore mënyra se si trajtohen, jo vetëm shqiptarët.

Është në zonën e sipërme të Pireut, pra nuk është tamam në Athinë. Dhe ishte një burg me një sipërfaqe të madhe që kishte shumë afër një heliport, nëpërmjet të cilit helikopteri mbërriti shumë shpejt. Sepse është edhe problemi i interceptimit: Ku po fluturon? Pse fluturon kaq ulët? e të tjerë. Ai e bëri shumë shpejt xhiron, u ul. Ndërkohë që Alket Rizajn po e merrnin, qëllueshin kullat e vërtetimit të policisë dhe çdo gjë mbaroi.

Po edhe në këtë rast, shërbimet sekrete greke hetuan policinë sepse dyshonin që ishin marrë lekë diku për të favorizuar këtë arratisje. Dhe sigurisht aty u pa dhe një lidhje e tij e ngushtë me botën kriminale greke, sepse ai u ndihmua së bashku me një kryemafioz grek të asaj kohe", tha Karamuço.

Më tej, eksperti shton se autoritetet greke kanë ngritur post-bloqe masive në autostrada dhe po kontrollojnë mjetet lundruese. Sipas Karamuços, kthimi ose kapja e tij nga policia greke është vetëm çështje kohe.

## LAJMI I FUNDIT

22:25 **Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president, reagon LVV**

22:17 **"Erion Veliaj mund të lirohet nesër", analisti tregon si do të procedojë Gjykata e Lartë me kryebashkiakun**

22:16 **Britani, burri rrëfen se e drogoi dhe përdhanoi gruan e tij për dy dekada**

SHPËRNDAJE  
ARTIKULLIN

22:04 **Sh-agjenti maroken ofroi informacione për spiunazhin e Marokut në këmbim të mbrojtjes nga ekstradimi në Spanjë**

21:48 **"Nëse Veliaj del nga burgu, do të jetë rrezik për Ramën", Zekthi: Do të rikthehet më i fortë politikisht**

21:44 **Afrika e Jugut, 21 të vdekur në një sulm me makinë-bombë**

TESTIM

“Ai nuk është shumë i sigurt jashtë burgut sepse ka dhe grupe rivale të cilat kanë kërkuar prej kohësh kokën e tij. Megjithatë është çështje kohe përpara se ai të rikthehet.

E gjithë Greqia është në një alarm të madh tani sepse kufijtë po kontrollohen, ka post-bloqe në Athinë dhe në qytete të tjera kryesore, sidomos në autostradën drejt Selanikut. Mendohet se mund të shkojë në Lindjen e Mesme me anije lundrimi, meqë janë me mijëra anije në Greqi dhe mund të jetë i fshehur në to. Kishte një sërë alternativash se si ai person mund të largohet dhe të shkojë në një vend të sigurt.

Megjithatë unë mendoj që do të kthehet shumë shpejt. Policia greke ka një qasje tjetër të sigurisë, interceptimit dhe inteligjencës të cilën ne nganjëherë duhet ta ndjekim sepse është goxha e fortë”, tha Ervin Karamuço.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET

Të rinjtë shqiptarë dhe kroatë bashkohen në Tiranë “për të ardhmen e përbashkët evropiane”

Unioni i Këshillave Studentorë dhe Ambasada e Kroacisë në Shqipëri, në bashkëpunim me projektin “Mbështetje për Integrimin në Bashkimin Evropian” (EUIS), zhvilluan në Tiranë tryezën...

20:08 | 14/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Koçiu për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri kriminale, ligji të veprojë shpejt

Zëvendëskryeministrja Albana Koçiu ka reaguar pas alarmit të rremë për bombë në një shkollë në Tiranë, duke e dënuar ashpër ngjarjen dhe duke e cilësuar...

17:57 | 14/09/2026

AKTUALITET | BOTA

Frikë nga zhvillimi i pakontrolluar i Inteligjencës Artificiale, bien aksionet në bursa

Thirrjet e drejtuesve të industrisë së inteligjencës artificiale për të ngadalësuar zhvillimin e teknologjisë kanë tronditur tregjet financiare. Aksionet e kompanive të lidhura me AI-në...

16:39 | 14/09/2026

TEMA

Vendi  
Rajoni  
Bota  
Video

SHËRBIME

Live  
Lajmi fundit  
Na ndiqni  
Euronews Radio  
Për persona me aftësi të kufizuara  
Rreth Euronews  
Kushtet e përdorimit  
Politika e cookie  
Kontakti

KOMPANIA

Follow Euronews on all platforms: